



01-1027

| | | |
|--|--|---------------------------------|
| | <p align="center">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p align="center">Komuna e Prishtinës Opština Prishtina –Municipality of Prishtina</p> | <p align="center">PRISHTINA</p> |
|--|--|---------------------------------|

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 351/04-74309/24 dt. 07.06.2024, të pronarëve Arber Jusufi dhe Rijad Jusufi nga fshati Dumnicë e Poshtme, me vendbanim në Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën afariste, ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 29.08.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

- I. I LEJOHET pronarëve Arber Jusufi dhe Rijad Jusufi nga fshati Dumnicë e Poshtme, me vendbanim në Prishtinë, sipas kërkesës 05 Nr.351/04-74309/24 dt. 07.06.2024, përdorimi ndërtesës afariste, me etazhitet B+P+1ET, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-50909/17 dt. 08.02.2017, si dhe Vendimit mbi plotësimin dhe ndryshimin me numër 05Nr. 351/02-20909/17 të datës 15.09.2017, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10665-0, ZK Prishtinë.**
- II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Lidhja e Pejës” ku ka dalje hyrjet e kjo ndërtesë me numër: 368 në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.**
- III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës në evidencat e regjistrit kadastral.**
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.**

A r s y e t i m

Pronarët Arber Jusufi dhe Rijad Jusufi nga fshati Dumnicë e Poshtme, me vendbanim në Prishtinë, me kërkesën me 05 Nr.351/04-74309/24 dt. 07.06.2024, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste, me etazhitet B+P+1ET, e ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10665-0, ZK Prishtinë, sipas sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-50909/17 dt. 08.02.2017, si dhe Vendimit mbi plotësimin dhe ndryshimin me numër 05Nr. 351/02-20909/17 të datës 15.09.2017, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Njoftim mbi inspektimin final", me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-54515/24 dt. 29.05.2024, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportin e Njoftimit mbi Inspektimin Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografii gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i punishtes Safer Jusufi; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Egurrona Myrtaj; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Dergut Leti; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjes dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Safer Jusufi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Mevlan Ramadani; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Muharrem Beka, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar për kryerjen e matjeve kadastrale Erzen Halimi me nr. të licencës 31;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjes dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht kompleksi i ndërtesave afariste mund të përdoren.

Bazuar në dëshminë e pronësisë për parcelën ndërtimore nr. 10665-0 ZK Prishtinë, pronari, nuk është më posedues i lejes ndërtimore, pasi që bazuar në aktin noterial "Aktvendim për trashigimi", I përpiluar te noteri Sefedin Blakaj në Prishtinë, Numri Rendor I LRP 2675/2021, Numri I Referencës 7332021, të datës 26.02.2021, nga pronarët Musa Jusufi është bartë pronësia të trashëgimtarët e tij përkatësisht te Arber Jusufi dhe Rijad Jusufi.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa afariste mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtest afariste.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certifikate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT SË PRISHTINËS,
05 NR. 351/04-74309/24 DT. 29.08.2024**

Zyrtari,
Bahtije Vllasaliu
B. Vllasaliu

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi
Nazife Krasniqi



